



NEN/DHJ 2021



TITUJT

Editorial: Dhuna ndaj grave dhe vajzave
faqja 1

Aktivitetet tjera të OKB-së: faqet 2-3

Në fokus: Prezantimi i analizës së femicidit
faqja 4

DATAT KYCE

NENTOR - DHJETOR

25 - 10 16 Ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore nisnin, që filluan më 25 nëntor, Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave dhe do të zgjasin deri më 10 dhjetor. Ditën e të Drejtave të Njeriut. Fushata në vend do të shënohet bashkërisht nga të gjitha agjencitë e OKB-së, OSBE-ja, Delegacioni i BE-së, Qeveria dhe sektori i OJQ-ve.

DHJETOR

2 Konferenca Vjetore e Kombeve të Bashkuara për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, këtë vit me fokus të veçantë në financimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

6 Promovimi i Hana-s, aplikacionit të parë natyror të sintezës së të folurit me zë në gjuhën shqipe, i cili do t'u mundësojë rreth 10,000 personave shqipfolës me dëmtime të shikimit nga rajoni të kenë qasje në platformën standarde moderne, të lehtë, funksionale dhe të qasshme për ofrimin e një spektri të gjerë aplikacionesh dhe shërbime – siç janë email, plejer muzike, navigacion, audio libra dhe shumë të tjera.

6-7 Zyra e UN Women në Maqedoninë e Veriut e organizoi një punëtori për planifikim strategjik me Komisionin për mundësi të barabarta dhe grupin punues ndërsektorial nga komuna e Velesit. Qëllimi i seminarit është t'ua prezantojë pjesëmarrësve konceptet bazë të barazisë gjinore dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor dhe bashkërisht t'i përcaktojë prioritetet strategjike për strategjinë e re katërvjeçare mbi barazinë gjinore (BGJ).

EDITORIAL Koordinator i përhershëm i OKB-së

Dhuna ndaj grave dhe vajzave nuk është e pashmangshme. Ajo mund të ndalet dhe duhet të ndalet!

Mjaft veprime po ndërmerren për ta ndaluar atë, në të gjitha nivelet, por mund të themi mjaftueshëm vetëm kur të gjitha gratë dhe vajzat të ndihet krejtësisht të sigurta dhe të mirëpritura në shtëpi, shkolla, vendin e punës, në internet apo kudo.

Për këtë ne kemi nevojë për ta vendosur një sistem të trefishtë në vend.

Shtylla e parë është e qartë – ne kemi nevojë për politikë dhe rregullore adekuate për të siguruar që gratë dhe vajzat të mbrohen ligjërisht nga të gjitha llojet e dhunës.

Unë jam jashtëzakonisht e lumtur që Maqedonia e Veriut ka arritur të rëndësishme në këtë drejtim. Pjesa më e madhe e legjisllacionit që ka të bëjë me dhunën ndaj grave dhe vajzave është në përputhje me Konventën e Stambollit, Konventën e OKB-së për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave dhe Standardet dhe Normat Evropiane. Mund të nevojiten disa përmirësime të mëtejshme, por në përgjithësi, korniza është e përshtatshme.

Shtylla e dytë, zbatimi, është edhe më e rëndësishme. Në këtë kontekst, pavarësisht progresit të qartë në vitet e fundit, Maqedonia e Veriut ka mundësi t'i shtojë përpjekjet në këtë drejtim.

Megjithatë, edhe sikur të kishim legjisllacion të përsosur dhe zbatim të plotë, prapëseprapë problemi nuk do të zgjidhej.

Çelësi për eliminimin e dhunës ndaj grave është ndryshimi i sjelljes sonë: normat tona, praktikat, politikat, qëndrimet tona dhe besimet tona. Ajo për të cilën vërtet duhet të punojmë, në nivel lokal dhe global, është të zbatojmë një sërë veprimesh që e nxisin politikën e zero tolerancës ndaj dhunës mbi bazë gjinore brenda çdo segmenti të jetës sonë.

Fëmijët janë e ardhmja jonë – andaj të gjithë duhet të sigurohemi që sistemi arsimor të jetë i përgatitur dhe i pajisur për ta futur politikën e zero tolerancës ndaj çdo forme dhune ndaj fëmijëve dhe të rinjve.



Ne duhet të sigurojmë që një politikë e tolerancës zero të zbatohet në të gjitha mjediset e punës, mjediset kulturore ose në internet.

Së dyti, duhet të krijojmë një mjedis të sigurt social në të cilin çdo rast do të raportohet dhe trajtohet me mbështetjen e duhur, jo vetëm nga institucionet përkatëse, por edhe nga komunitetet, duke mos lejuar asnjëherë që situata e viktimave të dhunës të përkeqësohet më tej nga stigmatizimi dhe abuzimi nga komuniteti.

Së fundi, dhe më e rëndësishmja, ne kemi nevojë që të gjithë të bashkohen. Nga shkollat dhe fabrikat e deri te organizatat fetare dhe shoqatat e prindërve, pra të gjithë duhet të marrin pjesë. Më tej do të jetë është shumë e thjeshtë.

Mos hesht!

Mos duro!

Jepi fund!

Росана Дуцак

Постојан координатор на Обединетите нации во Северна Македонија

AKTIVITETET TJERA TË OKB-SË

Konferenca Vjetore e Kombeve të Bashkuara 2021, me fokus në temën e financimit të OZhQ-ve në Maqedoninë e Veriut, u mbajt më 2 dhjetor 2021. Konferenca e hapi debatin mbi financimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (Financimi i OZhQ), duke u fokusuar në mjetet e financave publike dhe standardet e financave private, që mund ta përshpejtojnë përafirimin më të madh të financimit me qëndrueshmëri. Përfaqësues të nivelit të lartë nga qeveria, sektori financiar dhe organizatat ndërkombëtare, si guvernatorja Angelovska – Bezhoska, ministri Besimi, ministri Nuredini, drejtori ekzekutiv i Bankës Sparkasse Bishev, drejtuesi i Bankës Botërore në vend Paoluçi, Përfaqësuesi i përhershëm i UNDP-së Grigoryan, Përfaqësuesi i UNEP Iniciativës Financiare për Evropë, Buzas Luis dhe eksperti i ISAR-it Nanush, i diskutuan trendet aktuale dhe potencialet e ardhshme në Maqedoninë e Veriut në financimin e rrezikut të klimës dhe fatkeqësive, financave inovative, bankat e përgjegjshme, investimet dhe sigurimet, si dhe raportimin e korporatave për qëndrueshmëri dhe praktikën e qeverisjes së mirë mjedisore, sociale dhe korporative (QMSK). Gjithashtu, në konferencë u prezantua një analizë e re e OKB-së për Maqedoninë e Veriut e përgatitur me mbështetjen e ekspertëve nga ekonomisti Petreski i Finance Think – [Pasqyra e financimit të OZhQ-ve në Maqedoninë e Veriut 2021](#).

Video nga konferenca janë në dispozicion në linkat e më poshtëm:

- Video e shkurtër - Paneli 1 Financat publike ([English, Macedonian](#))
- Video e shkurtër - Paneli 2 Financat publike ([English, Macedonian](#))
- Gjithë konferenca e incizuar ([English, Macedonian, Albanian](#))

Në nëntor 2021, u publikua Profili i indikatorëve të qeverisjes mbi migracionin për vitin 2021 për Maqedoninë e Veriut dhe është i disponueshëm në anglisht, maqedonisht dhe shqip në ueb faqen IOM-it. Profili i indikatorëve të qeverisjes mbi migracionin (IQM) e paraqet një përmbledhje të fushave të zhvilluara mirëfilli të qeverisjes së migracionit në Maqedoninë e Veriut, si dhe fushat me potencial për zhvillim të mëtejshëm, siç vlerësohet përmes IQM-së. IQM-ja është një grup standard prej afërsisht 90 indikatorë për t'i ndihmuar vendet në vlerësimin e politikave të tyre të migracionit dhe për ta shpërthyer përpara bisedën se si mund të duket në praktikë migracioni i qeverisur mirëfilli. Publikimi është hartuar me mbështetjen financiare të Fondit të Mirëbesimit me më shumë Partnerë për Migracionin.

Në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë, Kryqin e Kuq, Shoqatën e Mjekëve të Maqedonisë dhe Shoqatën e Gjinekologëve dhe Obstetërve, gjatë muajit nëntor kanë përfunduar aktivitetet përfundimtare përgatitore për angazhim në terren të dy klinikave mobile gjinekologjike. Medikamentet, pajisjet, furnizimet, duke përfshirë pajisjet mbrojtëse personale, në vlerë të përgjithshme prej 110.000 dollarë amerikanë, janë dorëzuar në Klinikën Universitare për Gjinekologji dhe Obstetrikë në Shkup, si dhe në spitalet e Tetovës dhe Manastirit, për t'u siguruar që klinikat t'i kenë në dispozicion kërkesat, furnizime dhe materialet e nevojshme.

Duke filluar nga 1 dhjetori, do të vendosen klinikat mobile gjatë ditëve të punës në Sveti Nikollë, për të ofruar kontrolle gjinekologjike, depistime (kontrolle) për kancerin në qafën e mitrës, si dhe këshillim për planifikimin familjar dhe infeksionet seksualisht të transmetueshme. Për më tepër, do të jepet informacion në lidhje me raportimin e dhunës mbi bazë gjinore dhe kërkimin e mbështetjes nga ofruesit më të afërt të shërbimeve. Deri më 30 nëntor, mbi 100 gra kishin shprehur interes dhe kishin caktuar takime në klinikat mobile, duke shfaqur kërkesë të mëdha dhe nevojë reale për këtë lloj shërbimi.

Financimi për këto aktivitete vjen gjithashtu nga Fondi i Mirëbesimit me më shumë Partnerë për COVID-19.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet UNFPA-së dhe Byrosë për Zhvillimin e Arsimit në pilotimin dhe shtrirjen e Edukimit Gjithëpërfshirës Seksual (EGJS) në vend, më 9 nëntor 2021 UNFPA-ja organizoi takim pune - Shkëmbim përvojash në lidhje me zbatimin e Edukimit gjithëpërfshirës seksual në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Përfaqësues nga ministratë përkatëse, profesionistë të shëndetit publik, përfaqësues të akademisë, organizatave të shoqërisë civile, stafi i UNFPA-së nga vendet pjesëmarrëse dhe partnerët tjerë, patën mundësinë ta ndajnë



Marija Savovska, kryetare e OJQ-së Akcija Zdruzenska, gjatë prezantimit mbi shkëmbimin e praktikave me të mira për krijimin e politikave dhe buxheteve lokale përmes proceseve pjesëmarrëse. Foto: UN Women në Maqedoninë e Veriut

përvojën e tyre në programimin, hartimin, zbatimin dhe monitorimin e EGJS-së në vendet e tyre. Ky takim ishte hapi i parë drejt rritjes së bashkëpunimit të partnerëve nga Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Kosova.

UNFPA vazhdon t'i mbështesë autoritetet nacionale shëndetësore në procese të ndryshme, që synojnë përmirësimin e rezultateve të shëndetit të nënës. Në këtë drejtim, ofrohet mbështetje teknike dhe organizim i trajnimeve për kujdesin efektiv para lindjes për profesionistët shëndetësorë, siç është parashikuar me pilotimin e Master planit nacional për kujdesin efektiv para lindjes. Për më tepër, po bëhen përgatitjet përfundimtare për vënie në veprim të Sistemit të Mbikëqyrjes dhe Reagimit për çeshtjet e Obstetrikës në vitin 2022, i cili do ta mundësojë rishikimin/auditimin anonim të rasteve të rrezikut për jetën e nënave në lindje, duke i identifikuar kështu pengesat dhe pikat kritike që duhen adresuar dhe shmangur në të ardhmen.

UNOPS vazhdoi t'i forcojë kapacitetet e zyrës së Ombudsmanit përmes një punëtorie për nxjerrjen e mësimave nga rastet e njohura pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Punëtorja i ka zhvilluar më tej njohuritë dhe ekspertizën e stafit të Ombudsmanit në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e standardeve evropiane të të drejtave të njeriut, të zhvilluara nga praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Punëtorja i diskutoi gjithashtu specifikat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të pjesëtarëve të forcave të armatosura, duke përfshirë perspektivën e saj gjinore.

UNHCR në Maqedoninë e Veriut e organizoi një shkëmbim studimor në internet mbi marrëveshjet e kujdesit alternativ, të zbatuar nën kujdesin e projektit "Mbështetja rajonale IPA II për menaxhimin e emigracionit të ndjeshëm ndaj mbrojtjes në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi", financuar nga Bashkimi Evropian. Qëllimi i aktivitetit dyditor ishte shkëmbimi i njohurive dhe përvojave në lidhje me marrëveshjet e kujdesit alternativ për fëmijët e huaj, pavarësisht nga statusi i tyre i migrimit. Përfaqësuesit e UNHCR-së nga Holandë, Ministria e Drejtësisë dhe Sigurisë së Holandës, nga Agjencia Qendrore për Pranimin e Azilërkuesve dhe NIDOS, dhanë informacion të thellë në lidhje me kornizën mbrojtëse të fëmijëve në Holandë si në aspektin ligjor ashtu edhe në lidhje me procedurat miqësore për fëmijët duke përfshirë informimin, pritjen, përfaqësimin ligjor (procedura e azilit), arsimin dhe kujdesin shëndetësor.

Pas miratimit të Ligjit për ndihmën juridike falas në vitin 2020, i cili rregullon ofrimin e ndihmës juridike falas për azil dhe refugjatë, më 12-14 nëntor, UNHCR së bashku me partnerin e saj, MYLA (Asociacionin e avokatëve të rinj të Maqedonisë së Veriut) organizuan një ngjarje për ngritjen e kapaciteteve të titulluar "Ligji për refugjatët, sistemi i azilit dhe jurisprudenca përkatëse për avokatët e regjistruar në Ministrinë e Drejtësisë, me qëllim të ofrimit të ndihmës juridike falas për personat nën mandatin e UNHCR-së. Ky trajnim është pjesë e një sërë ngjarjesh dhe vizitash studimore të organizuara për zhvillim të kapaciteteve specifike të avokatëve për përfaqësim të personave nën mandatin e UNHCR-së

në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Si pjesë e përpjekjeve të Zyrës për nxitje të solidaritetit për refugjatët dhe personat pa shtetësi dhe për angazhim të personave me ndikim dhe artistë të shquar me angazhim shoqëror, UNHCR në Maqedoninë e Veriut e prodhoi një video ekskluzive të animuar për mediat sociale nga artisti vendas IndOg.

28 – 29 tetor 2021 - Zyra e UN Women në Maqedoninë e Veriut organizoi një punëtorë, që i bashkoi OSHC-të të cilat i zbatojnë iniciativat informuese dhe fuqizuese për rritjen e pjesëmarrjes së grave në proceset lokale të politikëbërjes dhe buxhetimit. Përfaqësues nga OSHC-të e Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë morën pjesë në një punëtorinë 2-ditore për shkëmbim të përvojave dhe praktikave me të mira për krijimin e politikave dhe buxheteve lokale përmes proceseve pjesëmarrëse dhe iniciativave të udhëhequra nga gratë. Ky shkëmbim përvojash ishte pjesë e projektit të UN Women "Promovimi i politikave dhe buxheteve të përgjegjshme gjinore: drejt qeverisjes transparente, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut", financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim. – Sida.

Partnerët e projektit AGORA dhe Këshilli nacional për barazi gjinore në kuadër të projektit të buxhetimit gjinor të OKB-së për gratë, e kanë zbatuar fazën përfundimtare të fushatës "Përfshihu - Pyet zëshëmi!", e cila ka të bëjë me angazhimin e grave në proceset vendimmarrëse në nivel lokal, dhe i paraqet praktikën me të mira të punës së tyre për përmirësimin e jetës së grave në komunitet.

Ambasada Suedeze, në bashkëpunim me zyrën e UN Women në Maqedoninë e Veriut dhe degën lokale të Uikipedias në gjuhën maqedonase – Njohuri të përbashkëta, e organizuan së bashku iniciativën UikiGap për ngushtimin e hendekut gjinor në internet, për të katërtën herë radhazi. Pjesëmarrësit/vullnetarët krijuan dhe/ose përkthyen tekste në gjuhën maqedonase për gratë (ose ngjarjet në lidhje me barazinë gjinore) të cilat kishin bërë një ndryshim të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit, ekologjisë dhe biodiversitetit. Ngjarja filloi më 15 nëntor 2021, e ndjekur nga një redaktim njëjavor. Gjatë javës së konkursit u krijuan gjithsej 929 artikuj, të cilët së shpejti do të publikohen në Uikipedia maqedonase.

Zyra e UN Women në Maqedoninë e Veriut e mbështeti iniciativën rajonale të UN Women "Të zgjuar, jo në gjumë: Rimendimi i përrallave për brezin e ri". Kalina Maleska, profesoreshë e letërsisë dhe autore nga Maqedonia e Veriut, ka arritur njohje të gjerë me përrallën e saj "Fëmija pa flokë të artë": <https://bit.ly/3l3sRE2>. Gjatë evenimentit të shënimtë të nisjes më 18 nëntor 2021, kjo përrallë u shfaq nga grupi teatror i kukullave të Maqedonisë së Veriut Hijet dhe Retë: <https://bit.ly/3xhWzaz>

UNODC organizoi një seminar mbi Shkëmbimin ndërinstitucional të Informacioneve në lidhje me procedurën penale në rastet që kanë të bëjnë me armët e zjarrit. Rreth 20 pjesëmarrës nga Ministria

AKTIVITETET TJERA TË OKB-SË



To mark the adoption of the United Nations Convention of the Rights of the Child – UNICEF and partners celebrate World Children's Day, an annual day of action for children, by children on November 20 and for a second year, World Children's Day took place during one of the most unique and challenging moments in our history.

e Punëve të Brendshme, Policia Kufitare, Prokurorët dhe Doganat diskutuan për bashkëpunimin mes tyre gjatë fazave të ndryshme të procedurës penale, duke përfshirë arrestimin dhe ndalimin nga policia, marrjen në pyetje të të dyshuarve, zhvillimin e aktakuzës dhe vlefshmërinë e provave.

UNODC në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Shkup e organizoi një konferencë në Shkup për ta mbështetur zbatimin e "Strategjisë Nationale të Maqedonisë së Veriut për kryerjen e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pronave", si dhe punën e Komisionit nacional të sapoformuar për monitorimin e zbatimit të Strategjia.

Qëllimi i konferencës ishte prezantimi i aktiviteteve në kuadër të strategjisë që kanë të bëjnë me forcimin e kapaciteteve institucionale për kryerjen e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pronave si dhe nevojat për mbështetjen e Maqedonisë së Veriut, me qëllim të zbatimit të suksesshëm të strategjisë. Objektivi kryesor i konferencës ishte iniciimi i punës për zhvillimin e një Udhërrëfyesi nacional për rikuperimin e pronave, i cili do të shërbejë si bazë për vlerësimin e aftësisë ekzistuese dhe identifikimin e boshllëqeve në proceset dhe burimet e alokuara për kryerjen e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pronave në Maqedoninë e Veriut.

Konferenca i mboldhi së bashku përfaqësuesit nga institucionet dhe organizatat nacionale dhe ndërkombëtare në Maqedoninë e Veriut, duke përfshirë Prokurorinë Publike, Ministrinë e Brendshme, policinë financiare, Drejtorinë e Doganave, Agjencinë për Menaxhimin e Pronave të Konfiskuara, Misionin e OSBE-së në Shkup, Këshillin e Evropës, GIZ, ambasadat e Suedisë, Francës, Holandës, Britanisë së Madhe si dhe përfaqësues të Komisionit nacional për monitorimin e zbatimit të Strategjisë.

Të gjithë pjesëmarrësit pranuan se koordinimi i donatorëve ndërmjet partnerëve ndërkombëtarë duhet të krijohet përmes një Udhërrëfyesi nacional për rikuperimin e pronave me qëllim të zhvillimit të një qasjeje koherente për zbatimin e Strategjisë dhe për të siguruar përdorim të përmirësuar dhe efikas të burimeve në ofrimin e mbështetjes për Maqedoninë e Veriut në realizimin e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pasurisë.

Programi i UNODC-WCO për kontrollin e kontejnerëve (CCP) në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) organizoi trajnim për oficerët e policisë kufitare dhe doganore të Njësisë së kontrollit të ngarkesave ajrore (ACCU) të themeluar në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit. Trajnimi ofron një mundësi për ta zgjeruar më tej punën bashkëpunuese në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit, dhe për ta stimuluar shkëmbimin e vazhdueshëm të informacioneve, për të arritur bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar, me qëllim të mbrojtjes së kufirit, dhe me theks të veçantë në sigurinë ajrore.

Në periudhën 18 – 25 tetor 2021, ekspertët e OBSH-së e përfunduan një mision teknik në Maqedoninë e Veriut për ta forcuar

gatishmërinë dhe reagimin ndaj emergjencave të shëndetit publik, duke përfshirë kontrollin e COVID-19, si pjesë e bashkëpunimit të ngushtë të vazhdueshëm me autoritetet nacionale shëndetësore. Ekspertët nga Zyra e OBSH-së në vend, Zyra Rajonale për Evropën, Qendra e Emergjencave Ballkanike e OBSH-së dhe Njësia e Menaxhimit të Krizave të Institutit Robert Koch në Berlin e vizituan Institutin e Shëndetit Publik (ISHP) në Shkup dhe dhjetë qendrat rajonale të shëndetit publik, e vlerësuan kapacitetin dhe nevojat e funksioneve aktuale të urgjencës së shëndetit publik dhe i identifikuan nevojat organizative, kapacitetet, burimet njerëzore dhe materiale. Pas një punëtorie dyditore të planifikimit, ekspertët e OBSH-së dhe autoritetet nacionale shëndetësore e zhvilluan së bashku një plan të detajuar operacional për përmirësimin e funksionalitetit të Qendrës Operative Emergjente (QE) dhe Rrjetit nacional të Shëndetit Publik në Maqedoninë e Veriut.

Për t'i mbështetur përpjekjet e Maqedonisë së Veriut për zbulimin, vlerësimin, analizimin dhe përgjigjen ndaj rreziqeve infodemike, të cilat ndërlidhen me pandeminë COVID-19, OBSH-ja e organizoi një trajnim për menaxhimin e infodemisë. Mbi 30 përfaqësues nga autoritetet nacionale shëndetësore, organizatat për verifikimin e fakteve, agjencitë e OKB-së dhe partnerët ndërkombëtarë i kanë përmirësuar aftësitë e tyre për përdorimin e analizave dhe qasjeve të bazuara në rreziq dhe prova, për ta menaxhuar infodeminë që e shoqëron pandeminë COVID-19.

Ekspertët nga Zyra e OBSH-së në vend, Zyra Rajonale për Evropën, Qendra e Emergjencave Ballkanike të OBSH-së dhe Njësia e Menaxhimit të Krizave të Institutit Robert Koch në Berlin bashkëpunuan me autoritetet nacionale shëndetësore për realizim të një Rishikimit të brendshëm të veprimit (IAR) lidhur me përgjigjen ndaj COVID-19 në Maqedoninë e Veriut. Në frymën e natyrës së zgjatur të pandemisë, Rishikimit të brendshëm të veprimit është një proces i udhëhequr nga vendi që u lejon vendeve ta rishikojnë përgjigjen e tyre ndaj COVID-19, t'i identifikojnë praktikatat më të mira, boshllëqet dhe mësimet e nxjerra, si dhe veprimet për korigjimin e menjëhershëm ose përmirësimin e qëndrueshëm të përgjigjes ndaj shpërthimit të COVID-19. Ky mision teknik është pjesë e mbështetjes së OBSH-së për autoritetet nacionale shëndetësore për t'u përgjigjur në mënyrë efektive pandemisë COVID-19.

Ekspertët nga OBSH dhe Edukimi Shëndetësor - Angli bashkëpunuan me palët e interesuara nacionale për ta eksploruar mundësinë e transformimit të Spitalit të Specializuar për Kujdesin Geriatrik dhe Paliativ në një qendër arsimore për subspecializimin e sapokrijuar geriatrik. Ky mision ekspertësh është një hap i rëndësishëm në përpjekjet për ta rritur numrin e specialistëve të trajnuar në kujdesin geriatrik dhe paliativ, për t'u përgjigjur nevojave në rritje të popullsisë së moshuar dhe për të ofruar kujdes të integruar dhe të përqendruar te personat për të moshuarit.

Në një takim të përbashkët me Ministrin e Shëndetësisë, Venko Filipçe, zyrat e OBSH-së dhe të UNICEF-it në vend injoan për

financimin e ri nga USAID për parandalimin dhe vaksinimin e infeksionit COVID-19. Me ndihmën e re, OBSH-ja do ta forcojë më tej kapacitetin e gatishmërisë dhe reagimit ndaj emergjencave të sistemit shëndetësor gjatë pandemisë COVID-19 dhe do të sigurojë mbulim më të lartë dhe shpërndarje të sigurt të vaksinave kundër COVID-19 në Maqedoninë e Veriut.

Me rastin e Javës Botërore të Ndërgjegjësimit Antimikrobik (WAAW) 2021 dhe me qëllim të adresimit të rezistencës antimikrobike, Komisioni multisektorial i Maqedonisë së Veriut për kontrollin e rezistencës antimikrobike (AMR) në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) dhe Odës Veterinare të Maqedonisë së Veriut organizuan bashkërisht më 15- 16 nëntor 2021 një seri uebinarësh edukativë me mbështetje me OBSH-së. Javë Botërore e Ndërgjegjësimit Antimikrobik, e festuar çdo vit nga 18 deri më 24 nëntor, synon ta rrisë ndërgjegjësimin për rezistencën globale antimikrobike dhe t'i inkurajojë praktikatat më të mira midis publikut të gjerë, punonjëseve shëndetësorë dhe politikëbërësve për ta shmangur shfaqjen dhe përhapjen e mëtejshme të infeksioneve rezistente ndaj ilaçeve.

Në periudhën 15 – 19 nëntor, ekspertët e OBSH-së e përfunduan një mision teknik për barazinë shëndetësore në Maqedoninë e Veriut. OBSH së bashku me ministrinë përkatëse, palët nacionale dhe partnerët ndërkombëtarë synojnë krijimin e një kornize nacionale për monitorimin e barazisë shëndetësore me përfshirjen e Ministrisë së Shëndetësisë të Maqedonisë, Entit Shtetëror të Statistikës, Njësisë së e-Shëndetit dhe disa institucioneve të specializuara shëndetësore si Instituti i Epidemiologjisë dhe Instituti i Shëndetit Publik.

Më 25 nëntor 2021, OBSH-ja e publikoi raportin "A mund t'ia dalin njerëzit të paguajnë për kujdesin shëndetësor? Dëshmitë e reja për mbrojtjen financiare në Maqedoninë e Veriut", që vlerësojnë shkallën në të cilën njerëzit në Maqedoninë e Veriut përtojnë vështirësi financiare, kur i përdorin shërbimet shëndetësore. Raporti është pjesë e një serie rishikimesh të bazuara në vend që e monitorojnë mbrojtjen financiare në sistemet shëndetësore në të gjithë Evropën. Gjetjet e raportit u diskutuan në një eventiment, ku u tubuan përfaqësues të sektorëve kryesorë përgjegjës të qeverisë, partnerëve ndërkombëtarë, shoqatave profesionale dhe organizatave të pacientëve dhe të shoqërisë civile.

OBSH-ja vazhdon ta lehtësojë qasjen në informacione, që shpëtojnë jetë dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë imunizimin kundër COVID-19, veçanërisht për komunitetet në rreziq, si të rinjtë, të moshuarit dhe popullata romë. Si pjesë e këtyre përpjekjeve, mbi 5,000 informacione dhe materiale që e adresojnë hezitimin ndaj vaksinës COVID-19 u shpërndanë anëtarëve të komunitetit rom. OBSH-ja po e mbështet gjithashtu linjën SOS të Kryqit të Kuq për COVID-19 për personat e moshuar.

Për të shënuar miratimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës – UNICEF-i së bashku me partnerët e kremenut Ditën Botërore të Fëmijëve, një ditë vjetore veprimi për fëmijët, nga fëmijët. Ky eventiment u zhvillua më 20 nëntor për të dytin vit me radhë. Dita Botërore e Fëmijëve u zhvillua gjatë njërit ndër momentet më unike dhe më sfiduese në historinë tonë. Pandemia e koronavirusit e ka ndryshuar jetën e fëmijëve dhe të rinjve në mënyra të thella dhe në një fazë të jetës së tyre ku ata duhet të zhvillohen për ta përmbyshur potencialin e tyre optimal. Mirëpo të rinjtë nuk kanë qëndruar duarkryq. Nëpërmjet konsultimeve rinore "Rimendo të ardhmen" – iniciativë që UNICEF-i e filloi një vit më parë së bashku me kabinetin e Presidentit Pendarovski - ata u mbledhën për ta vënë në rend të parë një ngjarje, ku do t'i ndajnë pikëpamjet dhe vizionin e tyre për të ardhmen, që e duan për veten dhe brezat e ardhshëm. Tre panelistët e rinj e e prezantuan Thirrjen e të rinjve për veprim, për ta rimenduar Arsimin cilësor, Klimën dhe Cilësinë e jetës. Mesazhi i tyre ishte i qartë - ata nuk duan të kthehen në normalitet pas COVID-19; ata kanë nevojë që vendimmarrës të punojnë me ta për ta ndërtuar më mirë të ardhmen. Gjatë ngjarjes vendimmarrësit, duke përfshirë anëtarë të parlamentit, përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare dhe ekspertë patën mundësinë të dëgjojnë më shumë nga panelistët e rinj dhe të përfshihen në një dialog të ngushtë gjatë diskutimeve në grupe më të vogla, të drejtuara nga të rinjtë. Ata diskutuan gjithashtu se çfarë veprimesh konkrete mund të ndërmerren për t'i adresuar çështjet në secilin nga tre temat.

Në vitet e mëparshme, me qëllim të manifestimit të mbështetjes,

AKTIVITETET TJERA TË OKB-SË

UNICEF-i u ka kërkuar partnerëve t'i ndriçojnë ndërtesat dhe monumentet me ngjyrë blu, për të ndihmuar në tërheqjen e vëmendjes ndaj shqetësimeve të fëmijëve dhe të rinjve. Këtë vit, për shkak të krizës aktuale të energjisë, UNICEF-i u kërkoi partnerëve ta theksojnë ngjyrën blu në kanalet e tyre të mediave sociale, duke iu bërë thirrje vendimmarrëse që t'i marrin në konsideratë thirrjet e të rinjve për veprim, për një të ardhme më të mirë për çdo fëmijë dhe të ri. Lexoni më shumë rreth thirrjeve të të rinjve për veprim.

UNICEF-i nisi iniciativën e Mbështetësve të drejtësisë për fëmijët – e para e këtij lloji në vend me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, në kuadër të Drejt(ësi) për fëmijëve – BE drejtësi në favor të të miturve dhe fëmijët. Qëllimi i nismës është të krijohet hapësirë për fëmijët dhe të rinjtë, që të marrin pjesë në reformat legislative dhe të politikave në fushën e drejtësisë për fëmijët dhe të gjenerojë mjete dhe mekanizma novatorë për t'i adresuar çështjet që e prekin jetën e tyre. 60 avokatë të fëmijëve dhe të rinjve kanë marrë pjesë në punëtorinë fillestare për të drejtat e fëmijëve nga data 12 deri më 14 nëntor. Në periudhën në vijim ata do të mësojnë se si t'i dizajnojnë mekanizmat dhe mjetet për qasje në drejtësi, në një punëtori për projektim të të menduarit, ndërkohë që do të mbështeten nga mentorë dhe ekspertë.

Në kuadër të të njëjtit aksion, UNICEF-i ka nisur edhe një sërë trajnimesh, duke filluar me trajnimin e punëtorisë së trajnerëve, për profesionistët që punojnë me fëmijët në kontakt me ligjin. Punëtorija për trajnimin e trajnerëve u përdor gjithashtu për ta verifikuar programin mësimor e drejtësisë për fëmijët, duke prezantuar një qasje shumësektoriale të bazuar në interesin më të mirë të fëmijës. Qëllimi është që të trajtohet çështja e ndryshimit të konsiderueshëm në njohuritë dhe aftësitë ndërmjet profesionistëve të ndryshëm që merren me fëmijët në rrezik dhe fëmijët në kontakt me ligjin. Profesionistët mësuam për qasjen e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës, duke u fokusuar në kompetencat kyçe si aftësitë e komunikimit ndërpersonal, angazhimi dhe mobilizimi i komunitetit, nëpërmjet studimeve të rasteve dhe praktikave më të mira nga Evropa. Gjithashtu u trajtuan parimet kryesore të drejtësisë për fëmijët, fëmijët në rrezik për t'u kontaktuar me ligjin, viktimat, dëshmitarët dhe fëmijët në konflikt me ligjin. Objektivi është të sigurohet që kontakti i fëmijës me sistemet e drejtësisë përfaqëson një mundësi, jo një kërcënim dhe se kalimi në sistemin e drejtësisë përbën një pikë kthese pozitive për fëmijët.

UNICEF-i organizon një sërë ngjarjesh për të ndarë dhe luajtur si për mësuesit ashtu edhe për prindërit, me qëllim që t'i njoftojë ata me burimet dhe strategjitë për të mësuarit social dhe emocional, të cilat ata mund t'i zbatojnë në klasa dhe në shtëpi. Evenimenti i parë është caktuar të mbahet më 4 dhjetor në Veles.

Më 22 nëntor, UNICEF e nisi EDUINO Gamethon, një sfidë krijuese për të mësuar dhe luajtur përmes aktiviteteve dhe lojërave të zgjedhura për fëmijët nga 3 deri në 10 vjeç. Qëllimi i Gamethon-it është të ta nxistë mësimin përmes lojës dhe t'i prezantojë mësuesit dhe prindërit me bibliotekën e hapur me aktivitete edukative në platformën EDUINO (<https://www.eduino.mk/igraton/>)

Këtë muaj UNICEF-i organizoi pesë uebinare për stafin e shkollës mbi temat përkatëse arsimore duke u fokusuar në përmirësimin e aftësive të mësuesve në krijimin e proceseve të mësimdhënies dhe të të nxënësit ndërvëprues dhe inovativ. Mbi 15000 edukatorë morën pjesë në këto uebinare. Seria e uebinareve do të vazhdojë në dhjetor. Për më shumë informacion vizitoni linkun.

Me rastin e Javës së BE-së për Reduktimin e Mbeturinave, UNICEF-i dhe partnerët e realizuan një punëtori me mësues të shkollave dhe edukatore të kopshteve, me temën e reduktimit, ripërdorimit dhe riparimit të mbeturinave, me fokus se si t'i integrojnë këto aktivitete praktikë dhe eksperimente në programet e tyre mësimore dhe të punojnë me fëmijët. Në punëtori morën pjesë 48 edukatore nga 16 kopshte dhe 77 arsimtarë nga 30 shkolla fillore.

- UNICEF-i e dorëzoi një furnizim të ri me pajisje mbrojtëse personale në vlerë prej 340,000 dollarë amerikanë, të cilat dhurohen për kujdesin shëndetësor, arsimin dhe institucionet mbrojtëse në Maqedoninë e Veriut. Donacioni vjen nga selia globale e furnizimit dhe legjistikës e UNICEF-it

- UNICEF-i e ka përfunduar vlerësimin e shpejtë të vetë-eftikasitetit, perceptimeve dhe qëndrimeve të punonjësve shëndetësorë (mjekëve familjarë, infermierëve të patronazhit, pediatërve dhe ekupeve të imunizimit) për imunizimin rutinë. Bazuar në njohuritë,



UNICEF-i do t'i zgjedhë, përshatë dhe përkthejë modulet e trajnimit të zhvilluara nga Zyra Rajonale. Trajnimet fillestare do të fillojnë në janar, në bashkëpunim me Shoqatën e mjekëve të Maqedonisë së Veriut.

në fillim të këtij viti, 5 prototipa të vaksinës MMRI janë projektuar dhe do të shpërndahen në të gjithë vendin për të rritur kërkesën për vakcina.

- Bazuar në gjetjet nga studimi i njohurive të sjelljes të përfunduar

Në Fokus Analizës së femicidit

Sipas një studimi të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin në vitin 2017 vranë gjithsej 87.000 gra në mbarë botën. Më shumë se gjysma e tyre janë vranë nga partneri intim ose një anëtar tjetër i familjes. I njëjti studim tregon se në vitin 2012 numri i grave të vrara nga partneri intim në nivel global ka qenë 48.000, gjë që tregon për një trend në rritje të numrit të femicideve ndër vite.


Fatkeqësisht, shifrat që i referohen Republikës së Maqedonisë së Veriut i konfirmojnë këto statistika shqetësuese. Midis viteve 2008 dhe 2020, gjithsej 96 gra janë vranë, nga të cilat të paktën 50 raste ishin femicide. Këto dhe gjetjet tjera dolën nga Analiza e rasteve të femicideve në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2017-2020, e mbështetur nga UNDP - pjesë e projektit "Përmirësimi i praktikave nacionale mbi armët e lehta dhe të vogla dhe Ndërtimi i komuniteteve rezistuese ndaj dhunës", të publikuara më 26 nëntor si pjesë e fushatës 16 Ditë e Aktivizimit kundër Dhunës mbi Bazë Gjinore.

Analiza është realizuar nga Rrjeti nacional për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, me mbështetjen financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë përmes "Udhërrëfyesit për zgjidhje të qëndrueshme ndaj posedimit, keqpërdorimit dhe trafikimit të paligjshëm të armëve të vogla dhe të lehta dhe municionet e tyre në Ballkanin Perëndimor deri në vitin 2024".

"Femicidi" i referohet vrasjes së grave dhe vajzave për shkak të gjinisë së tyre, i kryer dhe i toleruar nga personat privatë dhe publikë. Ai i mbulon vrasjet e grave, si rezultat i dhunës nga partneri intim, torturës dhe vrasjes mizogjene të grave, vrasjet e grave dhe vajzave në "emër të nderit" dhe vrasjet si rezultat i praktikave tjera të dëmshme, vrasjet e synuara të grave dhe vajzave në konfliktet e armatosura dhe rastet e femicideve të ndërlydhura me bandat, krimin e organizuar, trafikuesit e drogës dhe trafikimin e grave dhe vajzave.

Dhuna mbi bazë gjinore dhe femicidet si forma më e rëndë e dhunës, mund të ndodhin në të gjitha sferat e jetës. Gjetjet nga studimi tregojnë qartë se ky devijim shoqëror dhe pa diskutim kriminal nuk bën dallim sipas moshës, kombësisë dhe statusit socio-ekonomik. Analiza e përfshin periudhën 2017-2020, gjatë së cilës janë vranë gjithsej 26 gra, sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave. Nga këto, 22 vrasje (84%) mund të klasifikohen si femicide.

Nga analiza e rasteve të vrasjes së 16 grave, krimi mund të cilësohet si femicide në 14 raste. Në më shumë se 75% të rasteve të analizuara të vrasjeve të grave, krimi është kryer nga bashkëshorti aktual ose ish-bashkëshorti ose partneri jashtëmarteros me të cilin kanë bashkëjetuar në një komunitet. Në më shumë se 80% të rasteve, edhe pse ka pasur dhunë që më vonë është dëshmuar në procedurë nga familjarë të afërt të viktimës, prapëseprapë asnjë nga 14 gratë e vrarë nuk e ka raportuar të institucionet kompetente



dhunën që e kanë përjetuar. Shumica e grave të vrarë u ekspozuan ndaj më shumë se një forme të dhunës mbi bazë gjinore, dhe 6 prej tyre morën kërcënime me vdekje. Shumica e vrasjeve (50%) kanë ndodhur në shtëpinë e familjes, gjegjësisht në shtëpinë ku autori dhe viktimat kanë jetuar së bashku, ndërsa 25% e vrasjeve kanë ndodhur në shtëpinë, ku viktimat jetonte vetëm ose me prindërit e saj ose anëtarët tjerë të familjes.

Bazuar në këto të gjetura, analiza ofron rekomandime për politika dhe veprime për reduktimin e femicideve, të cilat mund të lexohen këtu: [Analiza e rasteve të femicideve në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2017-2020](#)

The latest version of the Sustainable Development Bulletin is available on UN North Macedonia website. For additional information, please contact rc-northmacedonia@un.org. Produced by the UN Resident Coordinator's Office in North Macedonia | 10 January 2022.

www.un.mk